

HEROI KOMBËTAR: PROPOZIM PËR NJË TEMË STUDIMI NË ANTROPOLOGJINË E MODERNITETIT

Abstrakt

Ky prezantim ndërtohet mbi shqetësimin se çfarë kontributi mund të japin studimet shqiptare në antropologjinë e modernitetit në leximin e figurës së heroit kombëtar të shqiptarëve, Gjergj Kastrioti, Skënderbeu. Duke u bazuar në perspektivën studimore të propozuar nga Domenic Boyer dhe Claudio Lomnitz (2005) për “një antropologji të intelektualëve” dhe Deborah Poole (1997) mbi “ekonominë vizuale”, propozimi i paraqitur në këtë fjalë apelon për kërkime të cilat do të duhet të shqyrtojnë raportin mes heroit kombëtar, shtetit, produktit intelektual, ideologjive populiste dhe njerëzve në shoqërinë moderne shqiptare.

Fjalë kyçe: Heroi kombëtar, intelektualët, ekonomia vizuale, nacionalizmi banal

Abstract

The following presentation raises a number of questions about the way(s) how an anthropology of modernity can provide a useful analytical tool for albanian studies to further understanding the role of the national hero in society and culture. Drawing on the work of Domenic Boyer and Claudio Lomnitz (2005) for an “anthropology of the intellectual” and Deborah Poole’s (1997) invitation to understand the “visual economy” of modern societies, the theoretical and empirical outline presented here invites researchers to investigate the relation between the national hero, the state, intellectual populist ideologies and everyday people in modern Albania.

Keywords: national hero, intellectuals, visual economy, banal nationalism

I.

Studimet etnografike shqiptare mbi Skënderbeun marrin formë gjatë dy periudhave të zhvillimit historik të kësaj dijeje që i përgjigjen fazave të caktuara të modernitetit shqiptar. Grupi i parë i studimeve me natyrë etnografike-historike, shtrihet mes viteve '20-'40 të shekullit XX. Kjo periudhë shënon stabilizimin e shtetit si entitet, ku shënohen edhe projektet e para modernizuese për shoqërinë shqiptare në kuadër të shtetit kombëtar. Ndërsa grupi i dytë i studimeve zhvillohet në vitet '50-'60 po të shekullit XX dhe përkon me stabilizimin e një modaliteti tjetër të palosjes së shtetërores, që vinte nën siglën ideologjike të socializmit shtetëror dhe diktaturës së proletariatit. Këtu shteti, nën regjimin e planeve 5-vjeçare, kërkonte shndërrimin e shoqërisë dhe kulturës shqiptare sipas një vizioni të caktuar ideologjik. Nën ombrellën e një shkence të shtetëzuar figura e heroit kombëtar u gjurmua edhe në etnografinë shqiptare. Kështu, në tubimin e dytë të studimeve albanologjike, kushtuar 500 vjetorit të vdekjes të Gjergj Kastriot Skënderbeut, etnografët shqiptarë do të fokusoheshin kryesisht mbi të drejtën zakonore dhe tema të tjera rreth saj. E drejta zakonore në tërësi do të mbetet tematika kryesore e hulumtimeve etnografike bashkë me mitologjinë dhe kulturën materiale rreth figurës së heroit.¹ Shënojmë se në optikën e përgjithshme lënda etnografike e mbledhur dhe analiza e saj nuk del jashtë kornizave epistemike mbi të cilën u ngrit dija etnologjike shqiptare gjatë komunizmit. (Bardhoshi dhe Lelaj 2018). Si e tillë, ajo që një farë *kordoni kërbizor* që ushqente studimet historike me të dhëna nga kujtesa popullore në ndërtimin e plotë të profilit të heroit kombëtar. Veç studimeve dhe materialit etnografik të publikuar, sidomos gjatë periudhës së diktaturës, në arkivin e etnografisë pranë IAKSA-së gjenden materiale etnografike ende të pa analizuar me fokus figurën e Skënderbeut, i cili është mbledhur gjatë diktaturës.² Pyetja që shtrojmë dhe mbi të cilën do të ndalemi në këtë kumtim lidhet me kontributin që mund të japin sot studimet

¹ Për një përmbledhje bibliografike të temave dhe autorëve, shih artikullin e Ermela Brocit në këtë numër.

² Për një analizë të materialit arkivor etnografik për Skënderbeun që ndalet veçanërisht tek e drejta zakonore, shih artikullin e Nebi Bardhoshit në këtë numër.

etnologjike/antropologjike në leximin e figurës së heroit kombëtar të shqiptarëve, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

II.

Një nga mënyrat për t'iu përgjigjur pyetjes sonë lidhet me shqetësimet qendrore teorike të antropologjisë klasike, e cila kishte të bënte me dhënien e përgjigjes pyetjes se: çfarë e mban bashkë shoqërinë dhe pse? Konceptet, si: *solidariteti, vetëdija kolektive, përfaqësitë kolektive*, të huazuara prej sociologjisë funksionaliste durkheimiane dhe të mbështetura në materiale të bollshme etnografike, u përdorën gjerësisht prej antropologëve në formulimet, analizat dhe përgjigjet ndaj pyetjes së shtruar. Tradicionalisht arsytimi antropologjik mbi këtë çështje dukej se i përgjigjej vetëm shoqërive të ashtuquajtura “primitive” dhe “tradicionale” prej të cilave buronte lënda etnografike. Ky perceptim u vu në pikëpyetje kur antropologët filluan të kërkonin përgjigjen e pyetjes edhe në shoqëritë moderne, sidomos në analizën e tyre mbi nacionalizmin. Bibliografia shkencore antropologjike mbi këtë çështje është e gjerë, me debate dhe kritika të frytshme. Pasqyra e plotë e debateve të zhvilluara ndërkohë është përtej logjikës së përgjithshme të këtij artikulli.³ Pavarësisht kësaj, e shoh të nevojshme të bëjmë disa shënime në palosjen e disa argumenteve që rrihen këtu e, veçanërisht, mbi rolin e intelektualëve në krijimin e përfytyrimit të kombëtares, pjesë e së cilës është dhe vetë ideja e heroit kombëtar. Gellner (1964; 2006 [1983]) pati argumentuar kohë më parë për rolin që luajnë intelektualët dhe proletariati në lëvizjet kombëtare. Madje, të parët do të qenë një aset i rëndësishëm për zhvillimin dhe mbajtjen në këmbë të kulturës së lartë, e cila përhapet nëpërmjet alfabetizimit të ndërgjegjeve në sistemin e ri arsimor të detyruar modern, që standardizon vetëdijet dhe mundëson komunikim mes të panjohurve. Këta të fundit, të zhveshur prej

³ Për një përmbledhje të tezave dhe debateve mbi kombformimin dhe çështjeve të tjera rreth tij nga perspektiva antropologjike, shih: Eriksen, H. Thomas. 2010 [1994]. *Ethnicity and Nationalism: An Anthropological Perspective*, botimi i tretë. London & New York: Pluto Press. Për një qasje më të gjerë në kuadrin e shkencave sociale dhe humane, shih: Smith, D. Anthony. 1998. *Nationalism and Modernism. A critical survey of recent theories of nation and nationalism*. London & New York: Routledge.

fisnores a familjares, veshin petkun e shtetasit të kombit dhe me veprime sa individuale, aq dhe kolektive, artikulojnë lidhje të reja shoqërore, nëpërmjet të cilave shquhet moderniteti. Arsimi i përgjithshëm i pajis njerëzit e kombit me dije si për veten e tyre kolektive, ashtu edhe për ekonominë e makinave industriale. Duke vijuar me logjikën e ndërtimit të kombit, Hobsbawn dhe të tjerë (2015 [1983]), hodhën ftesën për të parë dhe analizuar në mënyrë kritike proceset e “shpikjes së traditave” kombëtare moderne prej studiuesve dhe intelektualëve, të cilët nëpërmjet krijimit të ritualeve publike, veprave monumentale, himneve, publicistikes, folklorit dhe me radhë, kontribuonin në artikullimin dhe mbajtjen në këmbë të vetëdijes kolektive në shoqëritë shtet-kombëtare. Puna e intelektualëve në skalitjen e kombëtares theksohet edhe më shumë prej rolit të tyre në krijimin e imagjinatës dhe përfytyrimeve kolektive, nëpërmjet botimeve në gjuhët “vernakulare” të letërsisë, shkencës, dokumentit administrativ dhe shtypit të përditshëm. Revolucioni leksikografik, zhvillimi i tregut të librit dhe alfabetizimi, pohon Anderson, janë bazat mbi të cilat ngrihet “imagjinata” mbi veten kolektive si komb në shoqëritë moderne. “Shtypshkrimi është çka shpik nacionalizmin; jo një gjuhë e caktuar” (Anderson 2009 [1983], 134). Analiza e pozicionit të intelektualit në proceset kombformuese dhe në lëvizjet nacionaliste që pjesë e një reflektimi më të gjerë si mbi nacionalizmin, ashtu edhe mbi pozicionin e intelektualit në shoqërinë moderne në tërësi.⁴

III.

Me rënien e murit të Berlinit raporti mes intelektualit dhe artikullimit të kombëtares gjatë socializmave shtetërorë e, veçanërisht, në leximin e dinamikave dhe lëvizjeve nacionaliste që vijuan të formatonin dhunshëm shumë shoqëri, u rivendos në diskutim në agjendën e studiuesve të shkencave sociale dhe humane (Verdery 1991; Wachtel 1998; Sunny, Kenedy 2001). Nisur nga nevoja për t’u lexuar më tej, Boyer dhe Lomnitz (2005) ftojnë antropologjinë për ta thelluar dhe zgjeruar analizën dhe

⁴ Sigurisht që ky reflektim nuk pikënis në mes viteve ‘60-‘80 të shekullit të shkuar, kur këta autorë publikojnë punët në fjalë. Përkundrazi, së paku, prej iluministëve, te Marksi e deri te Raymond Aron, Foucault, Bourdieu dhe Bauman, pozicioni i intelektualit në shoqëri është vërejtur ngeshëm, analizuar, motivuar dhe kritikuar fort.

raportet mes intelektualit, kombit dhe nacionalizmit. Projekti kërkimor që parashtronë këta studiues reflekton antropologjikisht mbi intelektualët si agjenci a vepruese sociale dhe, veçanërisht, mbi praktikat se si ata e ushtrojnë dijen e tyre në shoqëri. Duke mbajtur fokusin në rolin e intelektualit në krijimin, qarkullimin dhe kontestimin e kulturës kombëtare, një antropologji e intelektualit kërkon të analizojë, ndër të tjera, përfshirjen dhe punën intelektuale që ndez dhe vë në lëvizje makinën nacionaliste nga letërsia, pedagogjia e deri te puna administrative për shtetin. Po ashtu, duke i bashkangjitur analizës diskursive materialet empiriko-entografike mbi profesionistët e shkolluar, panorama e proceseve të formimit dhe artikulimit të nacionalizmit, kombit, shtetit dhe kulturës publike në bashkëkohësi, bëhet më e plotë. Si e tillë, një “antropologji e intelektualëve që fokusohet te këta aktorë socialë të specializuar në prodhimin dhe administrimin e dijes sociale duhet të zërë një vend kyç në diskutimet bashkëkohore mbi kombin dhe nacionalizmin” (Boyer, Lomnitz 2005, 107-108). Nisur nga kjo optikë, një perspektivë e mundshme kërkimore mbi heroin kombëtar të shqiptarëve do të duhej të ndalonte në analizën antropologjike të rolit që luan ideja e heroit kombëtar në formësimin e vetëdijes kolektive, ku kjo e fundit shihet, njëherazi, si objekti sublim i ideologjive kombëtare, subjekt i strategjive endëse të shtetit modern dhe produkt i mjeshtërisë intelektuale. Kështu materiali etnografik i mbledhur dhe i publikuar gjatë komunizmit mbi Skënderbeun, së bashku me shtresëzimet e artikulimit të diskurseve në albanologji, pedagogji, arte dhe në publikën shqiptare të kohës në tërësi, do të duhej të qëmtoheshin në njërën anë, si materializim i idesë së heroit dhe, në anën tjetër, si fakte sociale që na ndihmojnë të ngremë një antropologji kritiko-reflektive mbi shtetin, shoqërinë dhe kulturën kombëtare. Në këtë mënyrë, të dyja bashkë, marrin të dhëna empirike dhe informojnë studiuesin e sotëm mbi proceset e prodhimit të vetëdijes kolektive, efektet e modernitetit, të politikave të kujtesës dhe harresës, krijimin e identitetit kombëtar, rolin e intelektualit, dijes dhe të (pu)shtetit modern në ndërtimin e figurës sa mitike, aq edhe historike të *Heroit kombëtar*. Po ashtu, në kontekstin tonë kjo optikë leximi merr një valencë specifike në analizën e thukët të raportit që ka dija në legjitimimin e pushtetit shtetëror diktatorial mbi shoqërinë. Ky zhanër hulumtimi, duke e zgjeruar rrjetën e tij, e mëkon kuptueshmërinë dhe analizën tonë kritiko-reflektive mbi mënyrat se si

lubrifikohen raportet shoqëri-shtet, nëpërmjet figurës së heroit kombëtar në modernitetin shqiptar, jo vetëm gjatë komunizmit, por edhe para dhe pas rënies së tij. Ndaj, reflektimi që shtrohet lidhet me shtetimin e heroit kombëtar si produkt intelektual dhe mbi instrumentalitetin e tij funksional në mbajtjen në këmbë të pushteteve të padrejta moderne apo në legjitimimin e rendit shoqëror ideologjikisht të projektuar prej shtetit. Kjo perspektivë kërkimore, përveç analizës së teksteve dhe materialit arkivor, i hapet terrenit dhe gjurmimit etnografik me të tjera pyetje që e thellojnë ndërthurjen dhe palosjen e politikave shtetërore identitet-formuese në kujtesën dhe vetëdijen kolektive tek shoqëria dhe individit i sotëm shqiptar. Leximi i optikës, që vjen prej *njerëzve të përditsbëm*, e plotëson dhe e zgjeron analizën antropologjike, duke vërejtur se si ideja e heroit kombëtar i artikulon dhe ndërmjetëson raportet mes individit-shoqërisë-shtetit edhe në postsocializëm. Për të sqaruar sa u parashtrua më lart, po japim dy shembuj ilustrativë që lidhen me vizualitetin e heroit në kulturën moderne shqiptare.

IV

Antropologia Deborah Poole (1997) na ka ftuar prej disa kohësh për të kuptuar formimin e idesë së “tjetrit” dhe “vetes” nëpërmjet rolit që luajnë imazhet në krijimin e përfytyrimeve kolektive në shoqëritë moderne. Për ta rrokur këtë aspekt studiuesit ftohen të analizojnë *ekonominë vizuale*, e cila i jep mundësi *prodhimit, qarkullimit dhe vlerës* së imazheve në shoqëri, nëpërmjet të cilave formohet imagjinata dhe përfytyrimi kolektiv në modernitet. Për më tepër, Poole parashtron se çdo analizë e ekonomisë pamore duhet të marrë në shqyrtim “sistemet kulturore dhe diskurset, nëpërmjet të cilave imazhet grafike vlerësohen, interpretohen dhe u jepet vlerë historike, shkencore dhe estetike” (Poole 1997, 10). Në këtë premisë, analiza e të gjithë infrastrukturës së prodhimit, qarkullimit dhe vlerës së imazhit të heroit kombëtar brenda ekonomisë vizuale të modernitetit shqiptar, rolit që kryen kjo ekonomi në lubrifikimin e raporteve individ-shoqëri, si dhe pozicioni i shtetit brenda saj, përbën një fushë studimore krejt të re brenda antropologjisë shqiptare mbi modernitetin. Duke u fokusuar tek të gjitha modalitetet e imazhit, bashkë me analizën e diskurseve rreth tyre, inkursionet empirike, analiza kritike që ofron dija antropologjike dhe teoria sociale, të gjitha së bashku do të na ndihmonin të kuptonim edhe më shumë

rolin e shtetit në krijimin e imagjinarit dhe përfytyrimit mbi heroin si mekanizëm për të dalluar dhe përforcuar idenë e “vetes” kolektive në shoqëritë shtetkombëtare. Por, gjithashtu, për sa kohë këto imazhe janë produkte të artistëve, ata na japin mundësinë të reflektojmë mbi rolin e intelektualit në ngjizjen dhe prodhimin e imagjinare kolektive mbi heroin kombëtar. Rasti më i mirë për ta ilustruar këtë fakt lidhet me imazhin e Skënderbeut që kemi prej punës të skulptorit Odhise Paskali. Puna e parë e Paskalit mbi heroin kombëtar me karakter publik është busti i Skënderbeut i vitit 1939, që u vendos në qytetin e vjetër të Kukësit. Kurse vepra e dytë monumentale e Paskalit që në bashkautorësi me Andrea Manon dhe Janaq Paçon. E titulluar “Monumenti i Skënderbeut në Tiranë”, ajo u inaugurua në vitin 1968, në kuadër të aktiviteteve përkujtimore që u organizuan me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar prej shtetit diktatorial shqiptar gjatë socializmit shtetëror. Këtu nuk jemi të interesuar për vlerat estetike dhe artistike të veprave, apo për raportin që ato kanë me “vërtetësinë” historike të imazhit. Por çështja që ka rëndësi për fokusin tonë kërkimor lidhet me mënyrën se si këto vepra qarkullojnë në sferën publike nëpërmjet mekanizmave shtetërorë, duke i dhënë formë dhe duke stabilizuar vizualisht tanimë idenë e heroit kombëtar ndër shqiptarë. Faktikisht këto vepra janë kthyer në kuintesencën pamore nëpërmjet së cilës imagjinohet heroi. Si pjesë përbërëse dhe produkt i kulturës së lartë, vendosja e këtyre veprave monumentale në hapësirën publike të dy qyteteve prej shtetit nuk mjaftonte, edhe pse monumenti i dytë që vendosur në kryeqytet në sheshin kryesor, i cili do të emërtohej më pas me emrin e heroit kombëtar. Kështu, bashkë me aktin e krijimit si produkt artistik, ngjizja e vazhdueshme e heroit nëpërmjet diskurseve intelektuale dhe roli që luan imazhi në të, mënyra e qarkullimit dhe vlera dhënë atyre, na tregojnë për mënyrën shtetërore të prodhimit të “vetëdijes kolektive”, e cila duhet të dallojë prej shtresëzimeve të tjera identitare bazuar në komunitete imediate, si: familja, fshati apo krahina. Rrjedhimisht, imazhi që Paskali ndërton, qarkullon nëpërmjet mekanizmave shtetërorë bashkë me idenë e heroit. Kështu ai do të imitohet prej artistësh të tjerë në përfundimin e heroikes. Pothuajse të gjitha imazhet e Skënderbeut të krijuara gjatë komunizmit në artet pamore ngjajnë shumë me njëri-tjetrin. Po ashtu, ky imazh do të shumëfishohet dhe qarkullojë nëpër kartolina, pulla poste, revista apo

gazeta. Ai do të përfshihet në tekste shkollore, ku nxënësit, ndërsa mësojnë për heroin kombëtar të tyre, do ta shoqërojnë leximin me imazhin e përfytyruar të Paskalit për të, duke u bërë edhe përfytyrimi i tyre. Imagjinaria kolektive që ngjiz artisti qarkullon prej shtetit edhe nëpërmjet parasë. (fig. 1)



Fig. 1. Paraqitje e imazhit të Skënderbeut të prodhuar prej Odise Paskalit në kartëmonedha.⁵

Ky imazh, që është njëherazi një përfytyrim dhe fryt i imagjinatës së artistit, vjen prej kulturës së lartë (*high culture*) dhe ushqen nacionalizmin shtetëror, duke zbritur drejt shoqërisë në të cilën do të qarkullojë nëpërmjet parave, kartolinave, filmit, pikturave apo ilustrimeve të ngjashme në tekstet shkollore për të zënë vend në të përditshmen. Por, imazhi i heroit në të përditshmen profane, fillon dhe e humbet autorësinë e artistit si dhe monopolin shtetëror në qarkullimin e tij. Ngadalë ai mori pronësi kolektive duke u bërë pjesë përbërëse e kulturës popullore moderne. Si i tillë, imazhi hyn në një realitet tjetër të ekonomisë vizuale, e cila është jashtë monopolit shtetëror. Në këtë realitet imazhi prodhohet, qarkullon dhe merr vlerë në nivelin horizontal të shoqërisë, mes njerëzve të zakonshëm. Edhe pse si

⁵ Marrë nga: <http://www.odhispaskali.com/Banknotes.htm>, konsultuar për herë të fundit më 05 shtator 2019.

ideja, ashtu edhe vetë përfytyrimi kolektiv mbi heroin kombëtar kalojnë nëpërmjet qarkullimit dhe pedagogjisë shtetërore tek individit, ky i fundit e shndërron atë duke e personalizuar. Në këtë aspekt, imazhi i heroit kombëtar, ndërsa del prej monopolit shtetëror të kontrollit të tij, artikulohet dhe qarkullon në shoqëri në mënyra të ndryshme. Për efekt ilustrimi të imazhit të heroit kombëtar në kulturën bashkëkohore popullore izolojmë tatuazhin (fig. 2), të cilin Billing (2002 [1995]) dhe të tjerë do ta lexonin si pjesë e nacionalizmit banal.



Fig. 2. Dy tatuazhe me imazhin e Skënderbeut.⁶

V

Praktika e bërjes tatuazh të simboleve kombëtare, bashkë me figurën e heroit kombëtar, shfaqet si dukuri gjithnjë në rritje në dekadën e fundit. Arsyet janë të ndryshme dhe kanë nevojë të lexohen në mënyrë më të detajuar, sidomos për të kuptuar raportin që ka praktika në fjalë me rritjen e diskurseve kombëtariste dhe politikave populiste në Shqipërinë

⁶ Faqe në Facebook: Gjergj Kastriot Skenderbeu, @The Great Skenderbeg, konsultuar për herë të fundit më 5 shtator 2019.

https://www.facebook.com/pg/TheGreatSkanderbeg/photos/?tab=album&album_id=313999985301746

bashkëkohore. Ndaj, si përfundim, diskutimi që paraqitëm më lart paraqet një propozim për një vektor të mundshëm kërkimi në antropologjinë shqiptare të modernitetit. Perspektiva këtu nis prej një premise, e cila nuk kërkon të thotë vetëm diçka mbi Skënderbeun, por, përkundrazi, kërkesa që parashtrohet është të lexojë se çfarë mund të thotë heroit kombëtar për shoqërinë moderne shqiptare.

Bibliografi

- Anderson, Benedict. 2009 [1983]. *Komunitete imagjinare: reflektime mbi origjinën dhe përhapjen e nacionalizmit*. Përkthyer nga Brenton Kotorri. Tiranë:Lindje-Perëndime.
- Bardhoshi, Nebi dhe Olsi Lelaj. 2018. *Etnografi në diktaturë: dija, shteti dhe "holokausti ynë"*. Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë.
- Billing, Michael. 2002[1995]. *Banal Nationalism*. London, Thousand Oaks, New Dehli: Sage Publication.
- Boyer, Domenic dhe Claudio Lomnitz. 2005. "Intellectuals and Nationalism: Anthropological Engagements". *Annual Review of Anthropology*. Vol.34:105-120.
- Gellner, Ernest. 2006[1983]. *Nation and Nationalism*. New York: Cornel University Press.
- Gellner, Ernest. 1964. *Thought and Change*. Chicago: University of Chicago Press, Chicago.
- Hobsbawn, Eric dhe Terence Ranger, përg. 2015[1983]. *Shpikja e traditës*. Përkthyer nga Doan Dani dhe Enis Sulstarova. Tiranë: Pika pa sipërfaqe.
- Poole, Deborah. 1997. *Vision, Race and Modernity: A Visual Economy of the Andean Image World*. Princeton. New Jersey: Princeton University Press.
- Suny, Grigor Roland dhe Michel D. Kennedy, përg. 2001. *Intellectuals and the Articulation of the Nation: An interdisciplinary look at the role of intellectuals in the making of nations*. Michigan: University of Michigan Press.
- Verdery, Katherine. 1991. *National Ideology under Socialism: Identity and Cultural Politics in Ceausescu's Romania*. California: University of California Press.
- Wachtel, Andrew. 1998. *Making a Nation, Breaking a Nation: Literature and Cultural Politics in Yugoslavia*. Stanford, California: Stanford University Press.